



7 arte

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të “7 arte”

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të “7 arte”, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2022, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të “7 arte” më 31 Dhjetor 2022, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që

përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



Astrit Musa – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
26 Prill, 2023

7 arte**Pasqyra e Pozitës Financiare****Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022**

		31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
PASURITË			
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	28,647	40,441
Llogaritë e arkëtueshme	4	9,118	-
Totali i pasurive qarkulluese		37,765	40,441
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i pasurive jo-qarkulluese		-	-
TOTALI I PASURIVE		37,765	40,441
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme tregtare	5	4,307	484
Totali i detyrimeve afatshkurta		4,307	484
Detyrimet afatgjata			
Të hyrat e shtyera	6	28,932	39,956
Totali i detyrimeve afatgjata		28,932	39,956
Rezervat			
Fondi Rezervë		4,526	-
Totali i rezervave		4,526	-
TOTALI I EKUITETIT AKSIONAR, I REZERVAVE DHE I DETYRIMEVE		37,765	40,441

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në 26 Prill 2023 nga:

Lulzim Hoti**Drejtor Ekzekutiv****Ardiana Koliqi-Metrama****Menaxhere e Financës dhe Administratës**

7 arte
Pasqyra e të ardhurave
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat	7	174,090	36,356
Totali I te hyrave		174,090	36,356
Shpenzimet			
Shpenzimet për paga	8	49,519	25,308
Shpenzimet operative	9	11,190	9,825
Shpenzimet e projektit	10	96,028	-
Shpenzimet e zyrës	11	12,827	1,223
Totali i shpenzimeve		169,564	36,356
Net Deficiti/Suficiti per vitin		4,526	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

7 arte

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

	Kapitali Aksionar në (EUR)	Fitimi/ Humbja e bartur në (EUR)	Rezervat tjera	Totali i Ekuitetit në (EUR)
Bilanci me 01 Janar 2021	-	-	-	-
Fitimet e mbajtura	-	-	-	-
Fitimi/humbja e vitit	-	-	-	-
Tërheqje dividendësh	-	-	-	-
Bilanci me 31 Dhjetor 2021	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
Bilanci me 01 Janar 2022	-	-	-	-
Fitimet e mbajtura	-	-	-	-
Fitimi/humbja e vitit	-	4,526	-	4,526
Tërheqje dividendësh	-	-	-	-
Bilanci me 31 Dhjetor 2022	<u>-</u>	<u>4,526</u>	<u>-</u>	<u>4,526</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

7 arte

Shënimet e rrjedhës së parasë

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Fitimi/Humbja në fillim	4,526	-
Rregulluar për:		
Amortizimin	-	-
Ndryshimi në te arketueshmet	(9,118)	-
Ndryshimi në të pagueshmet	3,823	484
Ndryshimi në të ardhurat e shtyra	(11,024)	39,956
Paratë e gjeneruara nga operacionet	(11,794)	40,441
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja/shitja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Rritja prej investimeve	-	-
Arketimet nga shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
	-	-
	-	-
Paraja neto e përdorur në financime	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(11,794)	40,441
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	40,441	-
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	28,647	40,441

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

7 arte

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

1. HYRJE

Që nga viti 1989-2000 rinia dhe kultura në Kosovë, pësoi një humbje të madhe e cila la pasoja të dukshme edhe në vitet pasuese, të njohura si faza e tranzicionit apo e pasluftës. Rimëkëmbja e kulturës dhe aktivizimit qytetar, posaqërisht i të rinjve, mbeti sfidë e vazhdueshme e shoqërisë.

Duke parë nevojën për zhvillim kulturor dhe aktivizim të të rinjve, më 2 maj të vitit 2006, me iniciativën e artistëve vendor u themelua organizata kulturore “7arte”.

Në po të njejtin vit, kjo organizatë antarësohet në Rrjetin e Kinemasë së Re Evropiane NISI MASA, me çrast artistëve të rinj u ofron mundësi më të shumta për bashkëpunim dhe promovim kulturor.

Krahas programeve kulturore, vizitave studimore, e shkëmbimeve të përvojave, 7arte arriti të ofrojë përvoja të reja profesionale për një numër të konsiderueshëm të artistëve kosovarë, si dhe të ndërtojë partneritete të dobishme në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

7 arte

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e përdorur

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Shkëmbimi i valutës së huaj

Organizata nuk kryen transaksione në valuta të huaja

2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë kosideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

2.5 Tatimet

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

2.6 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

2.7 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

7 arte

Shënimet e pasqyrave financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

2.8 Përfitimet e të punësuarve

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

7 arte
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

3. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Paratë në bankë	28,647	40,441
Paratë në arkë	-	-
Total paraja dhe ekuivalentët e parasë	28,647	40,441

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Llogaritë e arkëtueshme	9,118	-
Total I llogarive të arkëtueshme	9,118	-

5. LLOGARITË E PAGUSHME DHE SHPENZIMET AKRUALE

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Shpenzimet e kontributeve	2,196	298.88
Tatimi në paga dhe fitim i pagueshëm	2,111	186
Totali i të pagueshmeve	4,307	484

7 arte
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

6. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
KCSF (KCSF)	13,312	30,000
Anibar (Anibar)	-	4,312
MKRS (MKRS)	-	4,000
Caritas (Caritas)	-	900
Sponsorizimet (Sponsorizimet)	-	745
DKRS	2,009	-
United Nations	12,456	-
Të hyrat vetanake	1,156	-
Totali i të hyrave të shtyera	28,932	39,956

7. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Subvencionim		10,000
Grante	-	19,753
Sponsorizimi	745	4,600
Të hyrat nga shitja	-	2,003
Donacionet (Donations)	160,741	-
Të hyrat tjera	2,159	-
Të hyrat vetanake	10,446	-
Totali i të hyrave	174,090	36,356

7 arte

Shënimet e pasqyrave financiare

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

8. SHPENZIMET E PAGAVE

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Shpenzimet e pagave	49,519	25,308
Totali i shpenzimeve të pagave	49,519	25,308

9. SHPENZIMET OPERATIVE

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Shpenzimet e udhëtimit	589	809
Akomodimi për pjesëmarrësit gjatë seminarit	-	105
Komunalitë	1,707	470
Shpenzimet e komunikimit	150	295
Shërbime promovimi dhe publikimi (bilborde, këngë led, radio dhe TV, media elektronike dhe sociale, fotografi, katalog, fletushka, kartolina)	-	4,448
Dizajnimi dhe mirëmbajtja e faqes në internet	-	51
vullnetarët	-	543
CSR Kosova_Internal_Korrik_Gusht_Shtator	-	600
Shërbimet e sigurisë	-	369
Këndi kreativ_shpenzime	-	440
Bisedimet e Gjelbërta	-	492
Ndërtimi për Këndin Kreativ	-	362
Tarifat bankare	-	275
Programet Publike	-	400
Projekti i Asamblesë Vjetore për Hapësirat Kulturore	-	160
Shpenzime të panjohura	-	8
Shërbimet e kontabilitetit	900	-
Marketing	40	-
Transporti	1,904	-
Ngjitja e kapaciteteve	4,000	-
Shpenzimet e përkthimit	1,900	-
Totali i shpenzimeve operative	11,190	9,825

7 arte
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2022

10. SHPENZIMET E PROJEKTIT

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Mentorët / Ekspertët	30,313	-
Workshops / Trajnimet	13,906	-
Evente dhe takime	4,295	-
Materialet për aktivitete	9,572	-
Dizajni/publikimet & promocioni	11,029	-
Shërbime për monitorim (Shërbime të monitorimit dhe vlerësimit të projektit)	2,800	-
Shpenzimet e Projekteve	24,113	-
Totali i shpenzimeve të projektit	96,028	-

11. SHPENZIMET E ZYRËS

	31 Dhjetor 2022 (në EUR)	31 Dhjetor 2021 (në EUR)
Furnizime të zyrës	407	366
Mirëmbajtje dhe pastrim	996	210
Ushqim dhe pije	2,383	647
Të tjera	2,500	-
Shpenzimet e zyrës	6,541	-
Totali i shpenzimeve të zyrës	12,827	1,223

12. NGJARJET PASUES

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.